



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 01, datë 14.12.2022

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA
DIBËR, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.2, DATË 14.04.2017
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr.2, datë 14.04.2017 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Dibër”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Dibër, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 105 datë 09.11.2022, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Dibër, të miratuar me Vendimin Nr.2, datë 14.04.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e:
 - *Rregullores së Planit:*
 - Kudo ku ka shënime për lartësitë maksimale në kate dhe në metra, bëhen ndryshimet sipas përcaktimeve të dokumentit të rishikimit;
 - Në nenin 11 “*Sistemi Rezidencial (A)*”, pas pikës 2 shtohet pika 3;
 - Në nenin 32 “*Varreza (S.19)*”, pika 3 ndryshohet dhe pas saj shtohen pikat 4, 5 dhe 6;
 - Në nenin 63 me titull “*Brezat kufizues për ndërtimet (distanca nga rrugët dhe hekurudha)*”, pika 2, nënpika VI ndryshohet;
 - Pas nenit 63 “*Brezat kufizues për ndërtimet (distanca nga rrugët dhe hekurudha)*”, shtohet neni 63/1 “*Kufizimi i ndërtimeve përgjatë rrugëve të kategorive A, B dhe C*”;
 - Neni 67 “*Përcaktimi i zonave mbrojtëse përgjatë baseneve ujore (vija blu)*” ndryshohet;
 - Pas nenit 67 “*Përcaktimi i zonave mbrojtëse përgjatë baseneve ujore (vija blu)*”, shtohet neni 67/1 “*Burimet e ujrave*” dhe neni 67/2 “*Kanalet vaditëse/Emisaret*”;
 - Në nenin 72 “*Bashkimi i parcelave për qëllime zhvillimi dhe detyrimet përkatëse*”, pas pikës 6 shtohen pikat 7, 8 dhe 9;



- Pas nenit 72 “Bashkimi i parcelave për qëllime zhvillimi dhe detyrimet përkatëse” shtohet neni 72/1 “Rastet për të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm”, neni 72/2 “Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror”, neni 72/3 “Kushte për objektet ekzistuese në sistemin bujqësor dhe natyror” dhe neni 72/4 “Madhësia minimale e parcelës”;

- Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore;

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Dibër, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Dibër dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Dibër, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

